

VENDIM
Nr. 598, datë 1.7.2015

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE PËR VLERËSIMIN E
NDIKIMIT NË MJEDISIN NDËRKUFITAR¹**

(Ndryshuar me VKM nr. 580, datë 8.10.2025)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 23, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. PROCEDURA PARAPRAKE DHE NJOFTIMI I ZHVILLUESIT”

1. Zhvilluesi, që synon të zbatojë një projekt, i cili është subjekt i procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis, që në fazat fillestare të planifikimit të projektit/projektidesë, paraqet nëpërmjet sistemit elektronik pranë ministrisë përgjegjëse për mjedisin kërkesën dhe dokumentacionin e parashikuar në krerët I dhe II, të vendimit nr. 686, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”, të ndryshuar.

2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, pas marrjes së aplikimit nga ministria, ndjek procedurën e përcaktuar në vendimin nr. 686, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisë e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”, të ndryshuar, dhe vlerëson nëse projekti i propozuar është i listuar në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe nëse mund të ketë efekte të rëndësishme në mjedisin e një apo më shumë shteteve fqinje, bazuar në identifikimin e ndikimeve ndërkufitare, sipas shtojcës 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Kur plotësohen kushtet e pikës 2, të këtij kreu, Agjencia Kombëtare e Mjedisit njofton zhvilluesin se projekti i nënshtrohet vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) në kontekst ndërkufitar dhe i kërkon të plotësojë formatin e njoftimit të shtetit fqinj dhe dokumentacionin e kërkuar në të, bazuar në shtojcën 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Formatin dhe dokumentacionin, të përcaktuar në pikën 3, të këtij kreu, dorëzohen në ministrinë përgjegjëse për mjedisin dhe në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, brenda 10 (dhjetë) ditëve punë, dhe procedura e vlerësimit bëhet sipas parashikimeve të këtij vendimi.

II. NJOFTIMI NGA MINISTRIA I PALËS SË PREKUR

1. Zhvilluesi i projektit plotëson formatin e njoftimit dhe dokumentacionin e kërkuar në të, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze, me shpenzimet e tij.

2. Ministria, brenda 20 (njëzet) ditëve pune nga marrja e formatit të njoftimit dhe dokumentacionit shoqërues, përcjell praktikën në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë për të njoftuar palën e prekur për projektin e propozuar që do t'i nënshtrohet procesit të VNM-së në kontekst ndërkufitar, dhe e fton të marrë pjesë në procedurën përkatëse. Njoftimi shoqërohet me formatin e njoftimit të shtetit fqinj dhe dokumentacionin e kërkuar në të në gjuhën angleze.

3. Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë ia përcjell palës së prekur praktikën brenda 20 (njëzet) ditëve pune nga data e marrjes së saj.

4. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, brenda 20 (njëzet) ditëve punë nga data e marrjes së formatit të njoftimit dhe dokumentacionit shoqërues, përcjell praktikën për mendim/konsultim në lidhje me çështjet që kërkojnë të merren parasysh në raportin e VNM-së, duke theksuar edhe afatin prej 20 (njëzet) ditësh punë për dërgimin e mendimit të tyre tek institucionet e mëposhtme:

- a) Ministrinë e linjës, në varësi të projektit;
- b) Drejtoritë teknike të ministrisë, sipas specifikave të projektit;
- c) Institucionet e tjera që, në varësi të llojit të projektit, janë përgjegjëse për lejimin/autorizimin/licencimin e tij apo përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin, shëndetin publik dhe emergjencat natyrore e civile;
- d) Agjencia Rajonale e Mjedisit (ARM) në qarkun ku propozohet të zbatohet projekti, së cilës i jepen edhe udhëzimet përkatëse për marrjen e mendimit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- e) Njësia e vetëqeverisjes vendore ku propozohet projekti.

5. Nëse pala e prekur shpreh se nuk ka interes të marrë pjesë në procedurën e VNM-së në kontekst

¹ Ky vendim synon të bëjë përafrimin e plotë të Direktivës 2011/92/EU të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 13 dhjetor 2011, “Për vlerësimin e ndikimeve që shkaktohen në mjedis nga projekte publike dhe private” (celex-32011L0092, OJ. L 26, 28.1.2012), të ndryshuar me Direktivën 2014/52/EU, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 16 prill 2014 (celex-32014L0052, OJ. L 124, 25.4.2014).

ndërkufitar apo nuk shprehet brenda afatit të përcaktuar në njoftimin e ministrisë dhe në formatin e njoftimit, i cili nuk mund të jetë më shumë se 6 (gjashtë) javë, procedura e VNM-së vijon të kryhet pa përfshirjen e palës së prekur, në përputhje me procedurat e legjislacionit në fuqi për VNM-në.

6. Në rastin kur pala e prekur shfaq interes për të marrë pjesë në procedurën e VNM-së në kontekst ndërkufitar, ministria e fton atë të marrë pjesë në procedurat e VNM-së, si më poshtë:

a) Konsultimi për çështjet që duhet të trajtojë raporti i VNM-së;

b) Procesi i informimit dhe pjesëmarrjes së publikut, sipas procedurave të legjislacionit në fuqi për rregullat, kërkesat dhe procedurat për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore, si dhe procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi të palës së prekur;

c) Vendimmarrja lidhur me deklaratën mjedisore.

7. Pala e prekur, në rastin kur shfaq interes për të marrë pjesë në procedurën e VNM-së në kontekst ndërkufitar, duhet t'i dërgojë ministrisë emrin dhe të dhënat e personit/personave të kontaktit që do të koordinojë konsultimet dhe takimet dhe ministria këto të dhëna ia përjell Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

8. Ministria, në rast se gjykohet e nevojshme nga AKM-ja gjatë procedurës së VNM-së, mund t'i kërkojë palës së prekur informacion lidhur me gjendjen e mjedisit që ka gjasa të ndikohet në mënyrë të konsiderueshme. Pala e prekur përgjigjet në gjuhën angleze dhe përgjigja përfshin informacion në lidhje me madhësinë e zonës, gjendjen e mjedisit, aktivitetet e pajisura me leje mjedisi në atë zonë, zonat e mbrojtura dhe çdo informacion tjetër që pala e prekur gjykon të nevojshëm. Përgjigja dërgohet brenda një periudhe kohore të arsyeshme, por jo më shumë se dy muaj. Përkthimi i materialeve nga gjuha e palës së prekur në gjuhën angleze do të përballohet me shpenzimet e zhvilluesit të projektit.

9. Ministria i kërkon palës së prekur që, brenda dy muajve nga marrja e njoftimit, në rast se ka shfaqur interes për të marrë pjesë në procedurën e VNM-së në kontekst ndërkufitar, t'i dërgojë një përmbledhje në gjuhën angleze të komenteve dhe sugjerimeve të publikut të dhe autoritetit përgjegjës për mjedisin të palës së prekur, në lidhje me çështjet që kërkojnë të merren parasysh në raportin e VNM-së. Përkthimi i materialeve nga gjuha e palës së prekur në gjuhën angleze do të përballohet me shpenzimet e zhvilluesit të projektit.

10. Agjencia Kombëtare e Mjedisit njofton, me shkrim, zhvilluesin për çështjet që duhet të trajtojë në raportin e VNM-së, ku përfshin edhe informacionin e paraqitur nga pala e prekur sipas përcaktimeve të pikës 9, të këtij kreu, si dhe informacionin e paraqitur nga institucionet e konsultuara, sipas përcaktimeve të pikës 4, të këtij kreu.

11. Raporti i VNM-së në kontekst ndërkufitar, përveç kërkesave të metodologjisë kombëtare, ku përcaktohen metodikat dhe kërkesat për hartimin e raporteve të VNM-së, informacionit të paraqitur nga pala e prekur, sipas përcaktimeve të pikës 9, të këtij kreu, dhe informacionit të paraqitur nga institucionet e konsultuara, sipas përcaktimeve të pikës 4, të këtij kreu, duhet të përfshijë edhe informacionin e kërkuar në shtojcën 3, bashkëlidhur këtij vendimi.

III. PROCEDURA E DËRGIMIT TË RAPORTIT TË VNM-së

1. Ministria, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e dorëzimit të raportit të VNM-së nga ana e zhvilluesit, ia dërgon atë palës së prekur, së bashku me përmbledhjen joteknike të këtij raporti. Të dyja dokumentet duhet të jenë të përkthyer në gjuhën angleze me shpenzimet e zhvilluesit të projektit. Në shkresën përcjellëse duhet të shënohet dhe koha në të cilën pritet përgjigja nga pala e prekur, e cila nuk mund të jetë më shumë se dy muaj.

2. AKM-ja, brenda 10 (dhjetë) ditëve punë nga data e dorëzimit të raportit të VNM-së nga ana e zhvilluesit, dërgon një kopje të tij për mendim/konsultim, së bashku me përmbledhjen joteknike të këtij raporti, duke theksuar afatin prej 20 (njëzet) ditësh punë për dërgimin e mendimit të tyre, tek institucionet e mëposhtme:

a) Ministrinë e linjës, në varësi të projektit;

b) Drejtorinë teknike të ministrisë, sipas specifikave të projektit;

c) Institucionet e tjera që, në varësi të llojit të projektit, janë përgjegjëse për lejimin/autorizimin/licencimin e tij apo përgjegjëse për planifikimin dhe zhvillimin, shëndetin publik dhe emergjencat natyrore dhe civile;

d) Agjencia Rajonale e Mjedisit (ARM) në qarkun ku propozohet të zbatohet projekti, së cilës i jepen edhe udhëzimet përkatëse për marrjen e mendimit nga njësitë e vetëqeverisjes vendore;

d) Njësia e vetëqeverisjes vendore ku propozohet projekti.

3. Pala e prekur e shqyrton dhe e konsulton raportin e VNM-së bazuar në procedurat e përcaktuara në legjislacionin e saj kombëtar dhe i dërgon ministrisë komentet ose vërejtjet e përfuara nga publiku apo autoritetet.

4. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në bashkëpunim me zhvilluesin, organizon dëgjesat me publikun sipas procedurave të legjislacionit në fuqi për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore, ku fton edhe palën e prekur të marrë pjesë gjatë këtyre dëgjesave. Shpenzimet në këtë rast

mbulohen nga zhvilluesi.

5. *Agjencia Kombëtare e Mjedisit* dhe zhvilluesi duhet të marrin pjesë në dëgjesat e publikut të organizuara nga pala e prekur lidhur me konsultimin dhe shqyrtimin e raportit të VNM-së. Konsultimet në këtë fazë nuk mund të zgjasin më tepër se dy muaj nga data e marrjes së raportit të VNM-së nga pala e prekur. Shpenzimet mbulohen nga zhvilluesi.

6. Bazuar në rezultatet e dëgjesave, të përcaktuara në pikat 3 dhe 4, të këtij kreu, zhvilluesi përfshin në raportin përfundimtar të VNM-së komentet dhe sugjerimet lidhur me dhënien e alternativave për zgjidhjen e çështjeve/problemeve të ngritura gjatë debateve, si dhe komentet/sugjerimet nga institucionet e konsultura sipas përcaktimeve të pikës 2, të këtij kreu. Raporti përfundimtar i VNM-së i dërgohet Ministrisë dhe *Agjencisë Kombëtare të Mjedisit*.

7. *Agjencia Kombëtare e Mjedisit*, mbas paraqitjes së raportit përfundimtar të VNM-së nga zhvilluesi sipas pikës 5 të këtij kreu, shqyrton këtë raport brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune.

8. *Agjencia Kombëtare e Mjedisit*, gjatë fazës së shqyrtimit ndërmerr konsultime me autoritetin përgjegjës së palës së prekur lidhur me masat për minimizimin apo eliminimin e ndikimit të mundshëm ndërkufitar nga projekti i propozuar. Konsultimet në këtë fazë nuk mund të zgjasin më tepër se 30 (tridhjetë) ditë pune.

IV. MARRJA E VENDIMIT PËRFUNDIM-TAR

1. Ministria, pas shqyrtimit, harton deklaratën mjedisore, e cila firmoset nga ministri.

2. Deklarata mjedisore për projektin e propozuar bazohet në dokumentacionin dhe raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedisin ndërkufitar, në rezultatet e konsultimeve të realizuara me palën e prekur, në komentet / sugjerimet nga institucionet e konsultura, si dhe në komentet e publikut.

3. Ministria i dërgon një kopje të deklaratës mjedisore për zhvillimin e veprimtarisë në zonë kufitare palës së prekur, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e lëshimit të saj.

4. Nëse Ministria, pa filluar funksionimin projekti, merr informacion të ri për ndikime të tjera mjedisore negative ndërkufitare që mund të shfaqen, por që nuk ishin të ditura në momentin kur lëshoi deklaratën mjedisore dhe që mund të kenë ndikuar në përmbajtjen e saj, informon zyrtarisht palën e prekur.

5. Nëse pala e prekur kërkon të konsultohet për rishikimin e deklaratës mjedisore, ministria hyn në konsultime për nevojën e rishikimit ose jo të saj.

V. ANALIZA E VEPRIMTARISË GJATË USHTRIMIT TË SAJ

1. Nëse autoriteti kompetent i palës së prekur kërkon të kryhet një analizë për ndikimet mjedisore ndërkufitare pasi projekti ka filluar të funksionojë, ministria zhvillon konsultime me palën e prekur për kryerjen ose jo të kësaj analize, si dhe për çështjet që do të trajtohen në të.

2. Nëse do të zhvillohet analiza, ajo do të fokusohet në rivlerësimin e çdo ndikimi negativ përtej kufijve të parashikuar gjatë vendimmarrjes, duke përfshirë edhe çështjet e mëposhtme:

a) monitorimin e zbatimit të kushteve të deklaratës mjedisore dhe/ose lejes mjedisore si dhe efektshmërinë e masave të marra për zbutjen e ndikimeve mjedisore;

b) rivlerësimin e ndonjë ndikimi mjedisor negativ, me qëllim përmirësimin e masave për kontrollin e tij;

c) verifikimin e parashikimeve të ndikimeve mjedisore, me qëllim që të përdoret përvoja për veprimtari të njëjta në të ardhmen.

3. Në rastet kur ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe palës së prekur apo palëve të prekura është lidhur marrëveshje dy-a më-shumëpalëshe lidhur me procedurat e VNM-së ndërkufitare, bazuar në Konventën për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, atëherë do të zbatohen procedurat dhe rregullat e përcaktuara në to.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Të gjithë termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim që u jepet, përkatësisht, në:

a) ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar;

b) ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar;

c) Konventën për vlerësimin e ndikimit në mjedis në kontekstin ndërkufitar, Espoo, Finlandë, 25 shkurt 1991.

1. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1 shtator 2015.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA 1
LISTA E AKTIVITETEVE QË I NËNSHTROHEN PROCEDURËS
SË VNM-së NË KONTEKST NDËRKUFITAR

1. Rafineri të naftës bruto (duke përfshirë sipërmarrje për prodhimin e lubrifikanteve nga nafta bruto) dhe instalime për gazifikimin dhe lëngëzimin e 500 tonëve metrikë ose më tepër qymyr apo rërë bituminoze në ditë.

2. a) Termocentrale të prodhimit të energjisë dhe impiante të tjera të djegies me prodhim nxehtësie prej 300 megavat ose më shumë; b) Stacione bërthamore dhe reaktorë të tjerë bërthamorë duke përfshirë çmontimin dhe heqjen nga funksionimi të këtyre stacioneve dhe reaktorëve bërthamorë 1 (duke përfshirë impiantet kërkimore për prodhimin dhe konvertimin e materialeve të ndashme ose ushqyese, fuqia maksimale e të cilëve nuk e kalon 1 kW ngarkesë termike të vazhdueshme).

3. a) Instalime për ripërpunimin e karburantit bërthamor të rrezatuar.

b) Instalime të projektuara:

- Për prodhimin dhe pasurimin e karburantit bërthamor;
- Për përpunimin e karburantit bërthamor të rrezatuar ose mbetjeve me nivel të lartë radioaktiviteti;
- Për depozitimin përfundimtar të karburantit bërthamor të rrezatuar;
- Vetëm për depozitimin përfundimtar të mbetjeve radioaktive;
- Vetëm për ruajtjen (e planifikuar për më shumë se 10 vjet) të karburantit bërthamor të rrezatuar ose mbetjes radioaktive në një vend të ndryshëm nga vendi i prodhimit.

4. Instalime të mëdha për shkrirjen fillestare të gëzës dhe çelikut dhe për prodhimin e metaleve pa përmbajtje hekuri.

5. Instalime për nxjerrjen e asbestit dhe për përpunimin dhe transformimin e asbestit dhe produkteve që përmbajnë asbest: për produktet e asbest-çimentos, me një prodhim vjetor prej më shumë se 20 000 tonë metrikë produkt përfundimtar; për materiale fërkimi, me një prodhim vjetor prej më shumë se 50 tonë metrikë produkt përfundimtar dhe për përdorimin e llojeve të tjera të asbestit për më shumë se 200 tonë metrikë në vit.

6. Instalime kimike të integruara.

7. a) Ndërtimi i autostradave, rrugëve të shpejtësisë 2/ dhe linjave të distancave të gjata të trafikut hekurudhor dhe të aeroporteve 3/ me pistë bazë (ngritje-ulje) prej 2100 metrash ose më tepër.

b) Ndërtimi i një rruge të re me katër korsi ose më shumë, ose riorganizimi dhe/ose zgjerimi i një rruge ekzistuese me dy ose më pak korsi për të siguruar katër ose më shumë korsi ku kjo rrugë e re ose riorganizimi dhe/ose zgjerimi i seksionit të rrugës do të jetë 10 km ose më shumë në gjatësi të vazhduar.

8. Tubacionet me diametër të madh për transportimin e naftës, gazit ose kimikateve.

9. Portet tregtare dhe gjithashtu rrugët ujore të brendshme dhe portet për trafikun ujor të brendshëm që lejojnë kalimin e anijeve me tonazh mbi 1350 tonë metrikë.

10. a) Instalime të depozitimit të mbeturinave për djegie, trajtim kimik ose groposje për mbetje toksike dhe të rrezikshme.

b) Instalime të depozitimit të mbeturinave për djegie ose trajtim kimik të mbetjeve të parrezikshme me kapacitet mbi 100 tonë metrikë në ditë.

11. Diga dhe rezervuarë të mëdhenj.

12. Aktivitetet e nxjerrjes së ujërave nëntokësore ose skemat artificiale të ringarkimit të ujërave nëntokësore, ku vëllimi vjetor i sasive të ujërave të nxjerra ose të ringarkuara është 10 milionë m³ ose më shumë.

13. Prodhimi i letrës, brumit të letrës dhe kartonit me kapacitet 200 tonë metrikë në ditë ose më shumë, i tharë me ajër.

14. Miniera dhe kariera (gurore) të mëdha, nxjerrja dhe përpunimi në vend i mineraleve metalike ose qymyrit.

15. Prodhimi i hidrokarbureve në det. Nxjerrja e naftës dhe e gazit natyror për qëllime tregtare ku sasia e nxjerrë kalon 500 tonë metrikë në ditë në rastin e naftës dhe 500 000 m³ në ditë në rastin e gazit.

16. Impiante të mëdha për ruajtjen e naftës, produkteve petrokimike dhe kimike.

17. Shpyllëzimi i zonave të mëdha.

18. a) Punime për transferimin e burimeve ujore ndërmjet baseneve të lumenjve, ku transferimi synon parandalimin e pakësimit të ujërave, dhe ku sasia e ujërave të transferuara është më e madhe se 100 milionë m³ në vit;

b) Në të gjitha rastet e tjera, punime për transferimin e burimeve ujore nga basenet e lumenjve ku

rrjedha shumëvjeçare e basenit është më e madhe se 2000 milionë m³ në vit dhe ku sasia e ujit të transferuar është më e madhe se 5 për qind e kësaj rrjedhjeje. Në të dyja rastet përjashtohet transferimi i ujit të pijshëm me tubacione.

19. Impiante për trajtimin e ujërave të ndotura me kapacitet që e kalon ekuivalentin e një popullsie 150 000 banorë.

20. Instalimet për rritjen intensive të shpendëve dhe derrave që kanë më shumë se:

- a) 85 000 vende për zogj;
- b) 60 000 vende për pula;
- c) 3000 vende për derra (mbi 30 kg);
- ç) 900 vende për dosa

21. Ndërtimi i linjave ajrore të tensionit të lartë me një tension 220 kW ose më shumë dhe një gjatësi prej më shumë se 15 km.

22. Instalime të mëdha për shfrytëzimin e kombinuar të fuqisë së erës për prodhim energjie (fermat e erës).

* Shënim në lidhje me shtojcën:

Stacionet e fuqisë bërthamore dhe reaktorët e tjerë bërthamorë pushojnë së qeni instalime të tilla kur i gjithë karburanti bërthamor dhe elementet e tjera të ndotura radioaktive janë zhvendosur përfundimisht nga vendi i instalimit.

- “Autostradë” është një rrugë e projektuar dhe e ndërtuar për trafik automobilistik, që nuk u shërben zonave përreth dhe, e cila:

a) është e pajisur, me përjashtim të pikave të veçanta ose përkohësisht, me karrexhata të ndara për të dy drejtimet e trafikut, të ndara nga njëra-tjetra nga një vijë ndarëse që nuk shkelet nga trafiku ose, në raste të rralla, me mjete të tjera;

b) nuk ndërpritet në të njëjtin nivel nga ndonjë rrugë, shinë hekurudhe ose tramvaji apo rrugë këmbësorësh;

c) është e sinjalizuar në mënyrë të veçantë si autostradë.

- “Rrugë shpejtësie” është një rrugë e rezervuar për trafik makinash ku hyrja mund të bëhet vetëm nga kryqëzimet në disnivel ose kryqëzimet e kontrolluara dhe në të cilën veçanërisht ndalimi dhe parkimi janë të ndaluara përgjatë karrexhatave të lëvizjes.

- “Aeroport” do të thotë një aeroport që është në pajtim me përkufizimin e Konventës së Çikagos, të vitit 1944, për krijimin e Organizatës së Aviacionit Civil (aneksi 14).

SHTOJCA 2

IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË RËNDËSISHME MJEDISORE NDËRKUFTARE

Kritere të përgjithshme për të ndihmuar në vlerësimin e veprimtarisë:

1. Madhësia e projektit: Lloji i veprimtarisë, sipërfaqja e tokës që do përdoret dhe operacionet që do të kryhen në të, kapaciteti prodhues dhe lëndët e para, përdorimi i burimeve natyrore dhe sasia e tyre, lloji dhe sasia e shkarkimeve në mjedis, kërkesat dhe konsumi i energjisë, objektet dhe infrastruktura që do të ndërtohet, lloji i mbetjeve dhe sasia e gjenerimit të tyre.

2. Vendosja: Veprimtaria e propozuar do të zhvillohet në zonë ndërkufitare dhe pranë vijës kufitare, në një zonë të mbrojtur, me rëndësi ndërkombëtare, pranë burimeve ujore, në një zonë me ndjeshmëri ekologjike (habitat i llojeve), afër qendrave të banuara dhe në afërsi të objekteve kulturore, në një terren të pjerrët me ekspozim nga territori i shtetit fqinj.

3. Pasojat: Veprimtaria e propozuar do të ketë ndikime të rëndësishme negative mjedisore që dalin përtej kufijve territorialë të Republikës së Shqipërisë dhe në shkallë të ndryshme ndikojnë negativisht në vlerat natyrore të shtetit/eve fqinj, si dhe në shëndetin e popullsisë. Në disa raste, veprimtaria e propozuar mund të shkaktojë efekte të rëndësishme ndërkufitare shumë të zhvendosura nga vendi i zhvillimit të saj dhe që mund të kalojnë përtej kufijve të një shteti fqinj.

Çështje që duhet të merren në konsideratë lidhur me vlerësimin e rëndësisë së ndikimeve mjedisore:

- 1. Shkarkimet në ajër të gazeve ndotëse që mund të ndryshojnë cilësinë e ajrit në zonë;
- 2. Shkarkimet e lëndëve ndotëse në ujërat sipërfaqësor I², përrenj, lumenj, liqene dhe det;
- 3. Prerjet masive të drurëve apo shpyllëzimet në sipërfaqe të konsiderueshme;
- 4. Afërsia e vendndodhjes së projektit me zona të mbrojtura;
- 5. Mundësia që aktiviteti i propozuar të shkaktojë aksidente që mund të kenë ndikime ndërkufitare.
- 6. A lidhet aktiviteti i propozuar me ndonjë marrëveshje ndërkombëtare për çështjet mjedisore.

SHTOJCA 3

INFORMACIONI I KËRKUAR NË RAPORTIN E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS NDËRKUFITAR

Informacioni i përfshirë në raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis ndërkufitar duhet të përmbajë si minimum:

- a) Një përshkrim të aktivitetit të propozuar dhe qëllimin e tij;
- b) Kur është e përshtatshme, një përshkrim të alternativave të arsyeshme (për shembull, vendndodhjeje ose teknologjike) të aktivitetit të propozuar si dhe të alternativës së mosveprimit.
- c) Një përshkrim të mjedisit të mundshëm për t'u prekur në mënyrë serioze nga veprimtaria e propozuar e alternativat e saj;
- ç) Një përshkrim të ndikimit potencial të mjedisit nga veprimtaria e propozuar e alternativat e saj, si dhe një vlerësim i rëndësisë së tij;
- d) Një përshkrim të masave lehtësuese për të mbajtur në minimum ndikimin negativ në mjedis;
- dh) Një tregues të qartë të metodave parashikuese, supozimeve të theksuara, si dhe të dhënave përkatëse të rëndësishme për mjedisin që janë përdorur;
- e) Identifikim të mungesave në njohuri dhe pasiguri të ndeshura në përpilimin e informacionit të kërkuar;
- ë) Kur duhet, një përshkrim të programeve të monitorimit e drejtimit e të planeve për analizë pas projektit dhe
- f) Një përmbledhje joteknike, që përfshin prezantimin vizual, si harta, grafikë etj.

SHTOJCA 4

FORMATI I NJOFTIMIT TË SHTETIT FQINJ

Njoftimi që do t'i dërgohet autoritetit kompetent të shtetit fqinj përmban:

1. Informacion për projektin apo veprimtarinë:
 - a) Lloji i aktivitetit të propozuar;
 - b) A gjendet aktiviteti në listën e aktiviteteve të përcaktuara në aneksin I, të konventës së VNM-së në kontekst ndërkufitar;
 - c) Qëllimi i aktivitetit të propozuar;
 - ç) Madhësia e aktivitetit të propozuar;
 - d) Përshkrimi i shkurtër i aktivitetit të propozuar (teknologjia që do përdoret).
2. Kufijtë hapësinorë dhe kohorë të aktivitetit të propozuar:
 - a) Vendi ku do të ushtrohet projekti (hartë, skica, planimetri etj.);
 - b) Përshkrimi i shkurtër i mjedisit (mjedisi gjeografik e fizik dhe qendrat e banuara pranë tij);
 - c) Arsytet e përzgjedhjes së vendndodhjes;
 - ç) Afatet kohore të aktivitetit të propozuar (koha e ndërtimit dhe e funksionimit);
 - d) Harta dhe foto me informacion për aktivitetin e propozuar.
3. Të dhëna për ndikimet e mundshme mjedisore dhe masat zbutëse të parashikuara:
 - a) Qëllimi i vlerësimit (ndikimet kumulative, vlerësimi i alternativave etj.);
 - b) Ndikimet e mundshme mjedisore të aktivitetit të propozuar (natyra e ndikimit, ma-dhësia etj.);
 - c) Lëndët e para (materialet si lëndë e parë, burimi i energjisë etj.);
 - ç) Shkarkime në mjedis (lloji dhe përmasa e shkarkimeve në ajër /shkarkimet e lëngëta dhe mbetjet e ngurta);
 - d) Ndikimet e mundshme mjedisore ndër-kufitare (lloji, përmasa);
 - dh) Masat zbutëse të propozuara (nëse jepen masat për parandalimin, eliminimin, minimizimin dhe kompensimin e pasojave në mjedis).
4. Propozuesi i aktivitetit:

Emri, adresa, telefoni, faksi dhe adresën e komunikimit elektronik.
5. Pika e kontaktit:
 - a) Pika e kontaktit në Ministrinë e Mjedisit;
 - b) Autoriteti përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve lidhur me vlerësimin e ndikimit në mjedis;
 - c) Adresa, telefoni dhe numri i faksit, si dhe adresa e komunikimit elektronik;
 - ç) Autoriteti i vendimarrjes përfundimtare.
6. Afati brenda të cilit pritët përgjigje:

Afati kohor/data e fundit e dërgimit të përgjigjes në ministri.

VENDIM
Nr. 599, datë 1.7.2015

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR. 54, DATË 21.1.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I OBJEKTIT “STUDIM, PROJEKTIM, LIDHJA E RRUGËS TRANSBALLKANIKE ME SUPERSTRADËN FIER-VLORË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.199, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 54, datë 21.1.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në pikat 3 dhe 4, vlera “582 942 635.82 (pesëqind e tetëdhjetë e dy milionë e nëntëqind e dyzet e dy mijë e gjashtëqind e tridhjetë e pesë pikë tetëdhjetë e dy) lekë” bëhet “582 407 368.82 (pesëqind e tetëdhjetë e dy milionë e katërqind e shtatë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e tetë pikë tetëdhjetë e dy) lekë”.

2. Tabela bashkëlidhur vendimit zëvendësohet me tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



Nr	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Pronari	Sipërfaqe trualli	Sipërfaqe ndërtimi	Çmimi i truallit, lekë	Çmimi i ndërtimit, lekë	Vlera e truallit, lekë	Vlera e ndërtimit, lekë	Vlera truall dhe ndërtësë	Shënime
1	8605	33/426	Skender Alibehaj	64.1	0	8300	52,024.00	532,030.00	-	532,030.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	8605	33/377	Metlli Sinanaj	68.2	98.6	8300	52,024.00	566,060.00	4,817,237.40	5,383,297.40	Konfirmuar nga ZVRPP-ja. Mbajtur vlera e truallit për sipërfaqen e ndërtësës jashtë vijës së shpronësimit.
3	8605	33/373	Metlli Sinanaj	178	76	8300	52,024.00	1,477,400.00	3,377,804.00	4,855,204.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja. Mbajtur vlera e truallit për sipërfaqen e ndërtësës jashtë vijës së shpronësimit.
4	8605	33/402	Sami Kembaci	185	42.2	8300	52,024.00	1,535,500.00	2,195,412.80	3,730,912.80	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
5	8605	33/375	B.P. Mersini	146	82.5	8300	52,024.00	1,211,800.00	4,291,980.00	5,503,780.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
6	8605	33/19	B.P. Mucaj	0	60	8300	52,024.00	-	3,121,440.00	3,121,440.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
7	8605	33/345-Nd	Flamur Hoxha	0	63.7	8300	52,024.00	-	3,313,928.80	3,313,928.80	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
8	8605	33/45-ND	Matilda Bufazi	0	71	8300	52,024.00	-	3,693,704.00	3,693,704.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
9	8605	33/371	Matilda Bufazi	23.2	0	8300	-	192,560.00	-	192,560.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
10	8605	33/399	Danish Hoxhaj	272	99	8300	52,024.00	2,257,600.00	5,150,376.00	7,407,976.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja sipërfaqe banimi
11	8605	33/399	Danish Hoxhaj	0	72	-	52,024.00	-	911,875.00	911,875.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Sipërfaqe zdrukthëtarie vlerësim me situacion
12	8605	33/410 (33/310)	B.P. Bataj	239	111	8300	52,024.00	1,983,700.00	5,774,664.00	7,758,364.00	Konfirmuar nga ZVRPP
13	8605	33/381	Edmond Bregu	84.5	109	8300	52,024.00	701,350.00	5,670,616.00	6,371,966.00	Hipotekohet në emër të Bankës PRO Credit Konfirmuar nga ZVRPP
14	8605	33/382	Dashamir Rrapushi	367.1	131.4	8300	52,024.00	3,046,930.00	6,835,953.60	9,882,883.60	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
15	8605	33/358	Zace Sejdi	184.1	115.9	8300	52,024.00	1,528,030.00	6,029,581.60	7,557,611.60	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
16	8605	33/364	Lutfi Shuaipi	214.2	85.8	8300	52,024.00	1,777,860.00	4,463,659.20	6,241,519.20	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
17	8605	33/365	Thabit Shuaipi	161	139	8300	52,024.00	1,336,300.00	7,231,336.00	8,567,636.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
18	8605	33/372	Xhelal Mezani	234	66	8300	52,024.00	1,942,200.00	3,433,584.00	5,375,784.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
19	8605	33/379	Enver Mezani	305.5	374	8300	52,024.00	2,535,650.00	17,697,376.00	20,233,026.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja 2 kate, 162 m ² kati i parë, 212 kati i dytë. Mbajtur vlera e truallit për katin e dytë.
20	8605	33/390	Pellumb Lule	189.1	65.2	8300	52,024.00	1,569,530.00	3,391,964.80	4,961,494.80	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
21	8605	33/400	Erthem Driza	134.6	369.7	8300	52,024.00	1,117,180.00	17,537,582.80	18,654,762.80	Konfirmuar nga ZVRPP-ja kati I 165.4 m ² , kati II 204.3 m ² . Mbajtur vlera e truallit për katin II
22	8605	33/418	Metlli Shehu	248.2	80.8	8300	52,024.00	2,060,060.00	4,203,539.20	6,263,599.20	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
23	8605	2/201	Alban Gjolekaj	296.8	223	8300	52,024.00	2,463,440.00	10,572,152.00	13,035,592.00	Në favor të Intesa San Paolo. Konfirmuar nga ZVRPP 2 kate, K I 99 m ² , K II 124 m ² . Mbajtur vlera e truallit për katin e dytë.
24	8605	2/57+1-3	Bp. Diku	-	50	-	52,024.00	-	2,601,200.00	2,601,200.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
25	8605	2/57+1-1	Bp. Hysaj	-	50	-	52,024.00	-	2,601,200.00	2,601,200.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
26	8605	2/57+1-2	Bp. Hameti	-	65	-	52,024.00	-	3,381,560.00	3,381,560.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
27	8605	33/368	Miroshe Metushaj	27.5	0	8300	52,024.00	228,250.00	-	228,250.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
28	8605	33/331	B.P. Agalliu	600	0	8300	52,024.00	4,980,000.00	-	4,980,000.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
29	8605	33/335/1	Agron Dine, Ardian Dine, Engjell Dine, Leonel Kokoshi, Lindita Kili, Natasha Toto, Osvalda Balli, Selvi Sina,	275.53	0	8300	52,024.00	2,286,899.00	-	2,286,899.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja



		33/335/2	Sokol Kokoshi, Themida Kondi, Yllka Lamaj								
			Agron Dine, Ardian Dine, Engjell Dine, Leonel Kokoshi, Lindita Kili, Natasha Toto, Osvalda Balli, Selvi Sina, Sokol Kokoshi, Themida Kondi, Yllka Lamaj	890.47	0	8300	52,024.00	7,390,901.00	-	7,390,901.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
30	8605	33/340	B.P. Alibehaj	23.1	0	8300	52,024.00	191,730.00	-	191,730.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
31	8605	33/437	B.P. Agalliu	82.2	0	8300	52,024.00	682,260.00	-	682,260.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
32	8605	33/408	Hiqmet Shoraj	96.3	0	8300	52,024.00	799,290.00	-	799,290.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
33	8605	22/273	Mustafa Myzeqari	20.7	0	8300	52,024.00	171,810.00	-	171,810.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
34	8605	33/432	B.P. Agalliu	446.6	0	8300	52,024.00	3,706,780.00	-	3,706,780.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
35	8605	11/73/2	Moisi Lazaj, Fatmir Lazaj	194	0	8300	52,024.00	1,610,200.00	-	1,610,200.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
36	8605	11/75	B.P. Lulja	1848.5	0	8300	52,024.00	15,342,550.00	-	15,342,550.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
37	8605	11/84	Riza Lule	1511.9	0	8300	52,024.00	12,548,770.00	-	12,548,770.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
38	8605	11/92	B.P. Agalliu	2045.4	0	8300	52,024.00	16,976,820.00	-	16,976,820.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
39	8605	11/174	Shoqeria "Selmani" SH.P.K	506.6	0	8300	52,024.00	4,204,780.00	-	4,204,780.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
40	8605	11/141	B.P. Agalliu	8385.9	0	8300	52,024.00	69,602,970.00	-	69,602,970.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
41	8605	2/35	B.P. Agalliu	3687	0	8300	52,024.00	30,602,100.00	-	30,602,100.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
42	8605	2/65	B.P. Agalliu	2710.6	0	8300	52,024.00	22,497,980.00	-	22,497,980.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
43	8605	11/118	Mirjam Ibrahimimi	3594	0	8300	52,024.00	29,830,200.00	-	29,830,200.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
44	8605	11/139	B.P. Agalliu	1040	0	8300	52,024.00	8,632,000.00	-	8,632,000.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
45	8605	2/208/1	B.P. Agalliu	5400.1	0	8300	52,024.00	44,820,830.00	-	44,820,830.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
46	8605	2/209	B.P. Agalliu	731	0	8300	52,024.00	6,067,300.00	-	6,067,300.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
47	8605	11/82	B.P. Bino	4877.2	0	8300	52,024.00	6,746,793.33	-	6,746,793.33	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
					0	8300	52,024.00	6,746,793.33	-	6,746,793.33	
					0	8300	52,024.00	6,746,793.33	-	6,746,793.33	
					0	8300	52,024.00	6,746,793.33	-	6,746,793.33	
					0	8300	52,024.00	6,746,793.33	-	6,746,793.33	
					0	8300	52,024.00	1,349,358.67	-	1,349,358.67	
					0	8300	52,024.00	1,349,358.67	-	1,349,358.67	
					0	8300	52,024.00	1,349,358.67	-	1,349,358.67	
					0	8300	52,024.00	1,349,358.67	-	1,349,358.67	
					0	8300	52,024.00	1,349,358.67	-	1,349,358.67	
					0	8300	52,024.00	1,686,698.33	-	1,686,698.33	
					0	8300	52,024.00	1,686,698.33	-	1,686,698.33	
					0	8300	52,024.00	1,686,698.33	-	1,686,698.33	
					0	8300	52,024.00	1,686,698.33	-	1,686,698.33	
					0	8300	52,024.00	562,232.78	-	562,232.78	
					0	8300	52,024.00	562,232.78	-	562,232.78	
					0	8300	52,024.00	562,232.78	-	562,232.78	
48	8605	33/417	Maksim Hitaj	382	81	8300	52,024.00	3170600	4213944	7,384,544.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
49	8605	33/417	Maksim Hitaj		41				693825	693,825.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja, objekt soc-ek, vlera sipas situacionit
50	8605	2/35-nd	Eduart Feka		116	8300	52,024.00	962,800.00	6,034,784.00	5,071,984.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
51	8605	33/344-Nd	Kudret Zhorri	0	63.7	8300	52,024.00	-	3,313,928.80	3,313,928.80	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
52	8605	33/343	Bp. Mehmeti	20.32	82.68	8300	52,024.00	168,656.00	4,301,344.32	4,470,000.32	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
53	8605	33/359	Gjyzela Alibehaj	54	0	8300	52,024.00	448,200.00	0	448,200.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
54	8605	33/360	Gjyzela Alibehaj	54	0	8300	52,024.00	448,200.00	0	448,200.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
55	8605	33/404	Agim Shehu	225.3	64.7	8300	52,024.00	1869990	3365952.8	5,235,942.80	Konfirmuar nga ZVRPP-ja



56	8605	33/431-ND 3	Izet Shuaipi	0	36.57	8300	52,030.00	303531	1902737.1	1,599,206.10	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
57	8605	2/208-ND	Haki Haxhiraj	0	52.17	8300	52,030.00	433011	2714405.1	2,281,394.10	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
58	8605	33/431-ND1	Petrit Ismail Shuaipi	0	63.94	8300	52,030.00	530702	3326798.2	2,796,096.20	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
59	8605	2/65-ND1	Bashkim Kasa	0	83.12	8300	52,030.00	689896	4324733.6	3,634,837.60	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
60	8605	33/431-ND4	Adile Shuaipi	0	65.03	8300	52,030.00	539749	3383510.9	2,843,761.90	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
61	8605	33/431-ND2	Xhafer Ismail Shuaipi	0	56.41	8300	52,030.00	468203	2935012.3	2,466,809.30	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
62	8605	33/391-ND2	Arben Lule	0	70.15	8300	52,030.00	582245	3649904.5	3,067,659.50	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
63	8605	33/391-ND1	Gezim Haxhi Lule	0	63.13	8300	52,030.00	523979	3284653.9	2,760,674.90	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
64	8605	2/65-ND3	Bilbil Lloaj	0	62.24	8300	52,030.00	516592	3238347.2	2,721,755.20	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
65	8605	2/65-ND2	Armando Salataj	0	50.84	8300	52,030.00	421972	2645205.2	2,223,233.20	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
66	8605	33/54-ND	Zenel Qamil Qamili	0	77.55	8300	52,030.00	643665	4034926.5	3,391,261.50	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
67	8605	33/222ND	Emin Shehu	0	64.24	8300	52,030.00	533192	3342407.2	2,809,215.20	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
68	8605	33/430	Kastriot Lelaj	398.2	97	8300	52,030.00	3305060	5046910	8,351,970.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
69	8605	33/335/3	Nure Omeri	143.1	347.1	8300	52,030.00	1187730	16480953	17,668,683.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja, 2 kate, kati I 156.9 m ² , kati II 190.2 m ² . Mbajtur vlera e truallit për kII
70	8605	2/208/2	Lavdosh Xhaferaj	223.9	48.3	8300	52,030.00	1858370	2513049	4,371,419.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
71	8605	2/208/3	Kundret Kapaj	116.1	16	8300	52,030.00	963,630.00	832,480.00	1,796,110.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
72	8605	33/28-ND	Bajram Mustafa Guaci	-	109	8300	52,030.00		5,671,270.00	4,766,570.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
										582.407.368,82	

